



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____ 2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: /Shoqëria “FJORTES” me NIPT J97426201K, me adresë: Lagjja Osman Haxhiu, Rruga Demokracia, Objekt nr.1 Zona kadastrale nr.8605/

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-23312-03-29-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti 2 “Blerje benzinë për vitin 2022”**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria “FJORTES”

Emri i plotë i shoqërisë

J97426201K

Numri i NIPT-it

Vlera 3,039,595.672 (tre milionë e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë presje gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa tvsh
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. Shoqëria “GEGA CENTER GKG” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

K66801001T

Numri i NIPT-it

Vlera 2,904,756 (dy milionë e nëntëqind e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria “GEGA CENTER GKG” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

K66801001T

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme

1. Bazuar në njoftimin nr.2060 prot datë 23.03.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik përcaktohet se Akti normativ nr.5 datë 12.03.2022, duhet të mbahet në konsideratë nga autoritetet kontraktore që do të zhvillojnë procedura prokurimi për objektet e përcaktuara në të. Gjithashtu për efekt të transparencës, APP do të publikojë në faqen e saj të internetit, informacionin që do të dërgohet çdo ditë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sa i takon përditësimin të cmimeve të tregjeve ndërkombëtare të publikuara për artikujt e karburanteve.

2. Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 neni 45 pika 2.1 përcaktohet se Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngruhje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

- a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;
- b) elementet fiskale;

Në rastin konkret oferta e paraqitur nga shoqëria “GEGA CENTER GK” shpk

- Nuk i është referuar përditësimeve të fundit të publikuara nga APP sa i takon përditësimit të cmimeve të tregjeve ndërkombëtare të publikuara për artikujt e karburanteve, ku në datën dhe orën e hapjes së ofertave përditësimi i fundit ka qenë ai i datës 27.04.2022, kurse operatori ekonomik “GEGA CENTER GK” shpk i është referuar cmimit të bursës së datës 29.03.2022.
- Nuk i është referuar Akti normativ nr.5 datë 12.03.2022, sa i përket cmimit të vendosur nga Bordi i Transparencës i mbledhur në datë 27 prill 2022, ku për shitjen me pakicë ka vendosur që cmimi i gazoilit është 233 lekë/litri dhe cmimi i benzinës është 213 lekë/litri. Operatori ekonomik “GEGA CENTER GK” shpk ka ofertuar në total me cmimet 222.14 l/litri për gazoilin dhe 200.33 l/litri për benzinën, cmime që janë dukshëm të ndryshme dhe më të ulët se cmimet në fuqi në momentin e hapjes së ofertave, ndërkohë që bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 neni 107 pika 9 dhe 10, likuidimi do të bëhet sipas cmimit të bursës të publikuar në momentin e shitjes së mallit.
- Oferta ekonomike e paraqitur nga shoqëria “GEGA CENTER GK” shpk rezulton si oferta më e ulët ekonomike, krahasimisht me ofertën e paraqitur nga shoqëria “Fjortes” shpk, për shkak se është llogaritur mbi një cmim burse dhe elementët e tjerë fiskalë që nuk i përkon periudhës kur janë hapur ofertat. Në momentin e hapjes së ofertave kanë qenë në fuqi cmime më të larta burse, nga ato të referuar nga shoqëria “GEGA CENTER GK” shpk në ofertën e paraqitur. Referuar marzhit të fitimit të shprehur në vlerë absolute nga “GEGA CENTER GK” shpk është më i lartë se marzhi i fitimit i paraqitur nga shoqëria “Fjortes” shpk.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**Shoqëria “FJORTES” me NIPT J97426201K, me adresë: Lagjja Osman Haxhiu, Rruga Demokracia, Objekt nr.1 Zona kadastrale nr.8605**], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **3,039,595.672 (tre milionë e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë presje gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa tvsh** është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Dritan LELI